



MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 48, dt. 02.04.2015

Në mbështetje të nenit 47, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “*Për Trashëgiminë Kulturore*”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 02.04.2015, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projekt zbatimit për ndërtimin e rrjetit të shërbimeve të telekomunikacioneve në Bashkinë Orikum.
2. Ngarkohet shoqëria “NISATEL” sh.p.k të kontirbuojë në pajisjen me audio guidë për Parkun e Orikut në bashkëpunim me DRKK-Vlorë.
3. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore punimet të mbikqyren nga specialistë të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI